



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 mars 2026
Nr. ref.:RK 3007/26

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

rastin nr. KO81/26

Parashtrues

Presidentja e Republikës së Kosovës

**Vlerësim i “konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese sipas nenit 113 (3) (1)
të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Saj Vjosa Osmani-Sadriu (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës ose Presidentja).

Objekti i çështjes

2. Parashtruesja e kërkesës kërkon vlerësimin e *“konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese sipas nenit 113 (3) (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*, përkatësisht në mes të parashtrueses së kërkesës dhe *“grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit të Republikës së Kosovës”* në ndërlidhje me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ).
3. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme *“[...] në zbatimin e afateve ligjore të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të një (1) anëtari të KQZ-së, i cili nuk është emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese. Në veçanti, nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet duhet pasur parasysh domosdoshmërinë që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja lidhur me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”*

Baza juridike

4. Kërkesa është parashtruar duke u bazuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 3 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 31 (Saktësimi i kërkesës) dhe 32 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji); si dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 66 (Kërkesa në pajtim me nënparagrafin 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 mars 2026, parashtruesja e kërkesës, përmes postës elektronike, e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, të cilën kjo e fundit e regjistroi më 23 mars 2026.
6. Më 23 mars 2026, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR.KO81/26], caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues dhe, përmes Vendimit [Nr.KSH.KO81/26], caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Bajram Ljatifi dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 24 mars 2026, Gjykata i njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) parashtruesen e kërkesës; (ii) Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetarja e Kuvendit) me ç’rast kërkoi nga kjo e fundit që nga një kopje e kërkesës t’u dorëzohet të gjithë deputetëve; (ii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri); dhe (iv) Kryetarin e KQZ-së. Palët e interesuara të cekura më lart u njoftuan edhe për mundësinë e dhënies së komenteve deri më 26 mars 2026.
8. Më 25 mars 2026, Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejme: LVV) dorëzuan komentet e tyre lidhur me kërkesën.

9. Më 27 mars 2026, Gjykata, për komentet e pranuar nga LVV-ja e njoftoi (i) parashtruesen e kërkesës; (ii) Kryeministrin; (iii) Kryetaren e Kuvendit dhe (iv) Kryetarin e KQZ-së.
10. Më 30 mars 2026, gjyqtari Radomir Laban kërkoi përjashtimin e tij nga vendimmarrja lidhur me kërkesën KO81/26. Në të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, refuzoi kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Radomir Laban.
11. Më 30 mars 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi, njëzëri, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 28 dhjetor 2025, u mbajtën Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
13. Më 9 shkurt 2026, KQZ-ja, përmes Vendimit [Nr.01/235-2026], certifikoi rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 28 dhjetorit 2025, si në vijim: LVV – 51.10% (57 ulëse); Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK) - 20.19% (22 ulëse); Lidhja Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK) – 13.24% (15 ulëse); Srpska Lista (në tekstin e mëtejme: SL) – 4.49 % (9 ulëse); Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme: AAK) – 5.50% (6 ulëse); Kosova Demokratik Türk Partisi (në tekstin e mëtejme: KDTP) – 0.57% (2 ulëse); Za Slobodu Pravdu i Opstanak (në tekstin e mëtejme: SPO) – 0.51% (1 ulëse); Koalicija Vakati – 0.42% (1 ulëse); Nova Demokratska Stranka (në tekstin e mëtejme: NDS) – 0.41% (1 ulëse); Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: IRDK) – 0.29% (1 ulëse); Socijaldemokratska Unija (në tekstin e mëtejme: SDU) – 0.27% - (1 ulëse); Partia Liberale Egjiptiane (në tekstin e mëtejme: PLE) – 0.24% - (1 ulëse); PSA – 0.22% (1 ulëse); Jedinstvena Goranska Partija (në tekstin e mëtejme: JGP) – 0.16% (1 ulëse); dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: LPRK) – 0.12% (1 ulëse).
14. Më 11 shkurt 2026, u mbajt Seanca Konstituive, në të cilën u konstituua Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).
15. Më 9 mars 2026, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës u dërgoi shkresë grupeve më të mëdha parlamentare dhe subjekteve politike për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së.
16. Më 10 mars 2026, subjekti politik LDK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar një (1) anëtar për KQZ.
17. Në të njëjtën ditë, subjekti politik AAK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar një (1) anëtar për KQZ.
18. Në të njëjtën ditë, subjekti politik KDTP, që përfaqëson komunitetin turk me dy (2) deputetë në Kuvend, ka nominuar një (1) anëtare për KQZ.

19. Më 13 mars 2026, subjekti politik PDK, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar dy (2) anëtarë për KQZ.
20. Në të njëjtën ditë, subjekti politik Koalicija VAKAT, që përfaqëson komunitetin boshnjak me një (1) deputet në Kuvend, ka nominuar 1 (një) anëtar për KQZ.
21. Në të njëjtën ditë, subjekti politik SL, që përfaqëson komunitetin serb me nëntë (9) deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka nominuar një (1) anëtar për KQZ.
22. Në të njëjtën ditë, subjekti politik Partia Socialdemokrate e Ashkalinjve, që përfaqëson komunitetin ashkali me një (1) deputet në Kuvend, ka nominuar një (1) anëtar për KQZ.
23. Më 16 mars 2026, LVV, si grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend, i cili nuk ka të drejtë të marrë pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ka nominuar tre (3) anëtarë për KQZ.
24. Siç rezulton nga dosja e lëndës e dorëzuar nga parashtruesja e kërkesës, kjo e fundit ka emëruar nëntë (9) nga njëmbëdhjetë (11) propozimet e grupeve parlamentare/subjekteve politike, për dhjetë (10) pozitat për anëtarë të KQZ-së, të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës, përkatësisht Presidentja kishte emëruar dy (2) nga tre (3) kandidatët e propozuar nga LVV-ja dhe një (1) nga dy (2) kandidatët e propozuar nga PDK-ja, prandaj një pozitë për anëtar të KQZ-së kishte mbetur e plotësuar.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

25. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës kërkon vlerësimin e *“konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese sipas nenit 113 (3) (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*, në ndërlidhje me emërimin e anëtarëve të KQZ-së. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës kërkon që të bëhet *“vlerësimi preventiv i konfliktit të kompetencave në rastin kur Presidentja pranon më shumë propozime për emërim të anëtarëve në KQZ nga grupet parlamentare, sesa që është e përcaktuar me Kushtetutë”*, duke shtuar se *“një vlerësim i tillë nga ana e Gjykatës konsiderojmë se është i domosdoshëm për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe funksionimin demokratik e kushtetues të institucioneve, përkatësisht KQZ-së.”*
26. Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, parashtruesja e kërkesës konsideron se: (i) është palë e autorizuar për të ngritur çështjen e konfliktit të kompetencave bazuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) *“konflikti i kompetencave ngritet lidhur me kompetenca kushtetuese dhe atë specifikisht lidhur me nenin 4, paragrafin 3 dhe nenin 84, paragrafin 2 të Kushtetutës, sipas të cilëve Presidentja mveshet me obligimin për të garantuar funksionimin demokratik dhe kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë, e në rastin konkret Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”*; dhe (iii) ekziston një konflikt i kompetencave ndërmjet Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Kuvendit, grupeve parlamentare, për shkak se *“[...] lista e propozimeve të dërguara nga grupet parlamentare është numerikisht e papërputhshme me numrin e lejuar të anëtarëve të KQZ-së siç përcaktohet me nenin 139, paragrafin 4 të Kushtetutës [...]”*.

27. Parashtruesja e kërkesës thekson se: “[...] vlerësimi i konfliktit të kompetencave mes institucioneve kushtetuese përfshin vlerësim ex-ante të konfliktit të kompetencave.” Po ashtu, parashtruesja e kërkesës thekson se “[...] në rastin konkret, pranimi i më tepër propozimeve, si dhe mungesa e qartësive të nevojshme, po i pamundësojnë Presidentes ushtrimin e kompetencës së saj kushtetuese të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 84 paragrafi 2 të Kushtetutës.”, duke u referuar në rastet e Gjykatës [KO131/18](#), parashtrues Presidenti i Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri i 6 marsit 2019, paragrafi 97; dhe [KO80/10](#), parashtrues Dr. Fatmir Sejdiu, Aktgjykim 27 shtatorit 2010.
28. Më tutje, parashtruesja e kërkesës pretendon se rasti konkret dallon nga rasti [KO88/21](#) parashtrues Presidentja e Republikës së Kosovës, Aktvendim për papranueshmëri i 2 korrikut 2021, për shkak se “[...] konflikti aktual i kompetencave për të cilin parashtrohet ky rast, buron pikërisht në kompetencën kushtetuese të Presidentes të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 3 dhe nenin 84, paragrafin 2 të Kushtetutës.”
29. Përkitazi me kërkesën për vlerësim preventiv – ex ante të konfliktit të kompetencave, parashtruesja e kërkesës thekson se: “[...] zgjidhja e këtij konflikti kompetencash detyrimisht reflekton nevojën që të sqarohet çështja e ndarjes së anëtarit/anëtarëve të mbetur, në rastet kur janë më pak se gjashtë (6) grupe parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara.” Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që: “[...] të sqarojë se kujt i takojnë vendet e mbetura për anëtarë të KQZ-së në rastet kur kemi më pak se gjashtë (6) grupe parlamentare që nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara.”
30. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të miratojë masën e përkohshme për pezullimin e rrjedhjes së afateve lidhur me fillimin e mandatit të një (1) anëtari të KQZ-së; (ii) ta bëjë vlerësimin preventiv (ex ante) të konfliktit të kompetencave mes Presidentes dhe grupeve parlamentare si trupa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kur këta të fundit dërgojnë numër më të madh propozimesh sesa numri i përcaktuar i anëtarëve të KQZ-së; (iii) ta zgjidhë konfliktin kushtetues të kompetencave, duke sqaruar se mbi çfarë kriteresh duhet ndarë vendet e mbetura në KQZ, në rastet kur kemi më pak se gjashtë (6) grupe parlamentare në Kuvend nga radhët e atyre të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara.

Kërkesa për masë të përkohshme

31. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme “[...] në zbatimin e afateve ligjore të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të një (1) anëtari të KQZ-së, i cili nuk është emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese. Në veçanti, nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet duhet pasur parasysh domosdoshmërinë që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja lidhur me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”

Komentet e LVV-së

32. Fillimisht, deputetët e LVV-së theksojnë se kërkesa e tyre për propozimin e tre (3) anëtarëve të KQZ-së mbështetet në paragrafin 4 të nenit 139 të Kushtetutës, në nenin 61,

paragrafi 3, pika a) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe në Aktgjykimin e Gjykatës [KO58/19](#), parashtrues Bilall Sherifi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, ata konsiderojnë se “[...] ndarja e vendeve shtesë në KQZ duhet të jetë e tillë që “partitë politike apo koalicionet që përfaqësojnë pozitën dhe opozitën” së paku të jenë të përfaqësuara në mënyrë të balancuar sipas sistemit proporcional, për të mundësuar funksionimin e KQZ-së dhe stabilitetin si institucion i pavarur kushtetues, pa diskriminim, respektivisht pa majorizim, në përputhje me nenin 24 të Kushtetutës.”

33. Lidhur me këtë, deputetët e LVV-së konsiderojnë se interpretimi i paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës duhet të bëhet në atë mënyrë që, pasi grupet parlamentare të kenë nominuar nga një anëtar për KQZ, “anëtarët shtesë” të emërohen proporcionalisht sipas rezultatit zgjedhor, me ç’rast rezulton se LVV në zgjedhje ka fituar 57 (pesëdhjetë e shtatë) mandate, në raport me 43 (dyzet e tri) mandate që kanë fituar subjektet e tjera politike nga 100 (njëqind) vendet në Kuvend, pa llogaritur vendet e rezervuara. Prandaj, ata konsiderojnë se bazuar në këtë përbërje të Kuvendit, “[...] shpërndarja reale e vendeve në KQZ për subjektet shqiptare, sipas interpretimit të dhënë në KO58/19 dhe pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të datës 28.12.2025, është si vijon: LVV – 3 anëtarë, PDK – 1 anëtar, LDK – 1 anëtar dhe AAK –1 anëtar.” Gjithashtu, deputetët e LVV-së i referohen Aktgjykimit KO58/19 dhe theksojnë se: “Nga ky interpretim rrjedh qartë se ndarja e vendeve në KQZ: - nuk bazohet në koalicione paszgjedhore; - nuk bazohet në ndryshime të mandateve gjatë legjislaturës; - por bazohet ekskluzivisht në rezultatet e fundit të certifikuara nga KQZ.”
34. Tutje, deputetët e LVV-së theksojnë se “çdo interpretim që do të rezultonte në një përfaqësim më të ulët të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në KQZ se ai që rrjedh nga pesha e saj reale parlamentare, do të binte ndesh jo vetëm me Aktgjykimin KO58/19 dhe nenin 139 të Kushtetutës, por edhe me parimet themelore të barazisë së votës, sigurisë juridike, përfaqësimit demokratik dhe standardet ndërkombëtare për administrimin e zgjedhjeve. Deputetët e LVV-së konsiderojnë se “[...] një interpretim që do të reduktonte përfaqësimin e subjektit më të madh parlamentar do të ishte në kundërshtim edhe me parimin e mosdiskriminimit ndërmjet subjekteve politike, pasi do të trajtonte në mënyrë të pabarabartë subjekte me peshë të ndryshme parlamentare, pa një bazë të arsyeshme dhe objektive.”
35. Në fund, deputetët e LVV-së propozojnë që Gjykata: “(i) TË KONSTATOJË se përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të reflektojë përbërjen e Kuvendit në mënyrë proporcionale sipas rezultateve të fundit të certifikuara zgjedhore; (ii) TË VLERËSOJË se, bazuar në rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve të datës 28.12.2025 dhe në peshën parlamentare prej 57 mandateve, Lëvizja VETËVENDOSJE! (LVV) i takojnë 3 (tre) anëtarë të KQZ.”

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

[...]

“3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe

garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.”
[...]

Neni 84 **[Kompetencat e Presidentit]**

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(2) *garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;*

[...]

(9) *mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;*

[...]

(26) *emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;*

[...].”

Neni 139 **[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]**

“1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

2. Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.

4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.”

Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (i publikuar në Gazetën Zyrtare më 3 korrik 2023)

Neni 61 **(Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së)**

“1. Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtim me nenin 139 paragrafi 3 të Kushtetutës.

2. Mandati i Kryesuesit të KQZ-së është shtatë (7) vjet, duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.

3. Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben më shumë se dy (2) mandate.

4. Anëtarët e KQZ-së nuk mund të shërbejnë më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme dhe në pajtim me nenin 139 paragrafi 4 të Kushtetutës dhe emërohen si në vijim:

4.1. gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë (6) grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të

marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë;

4.2. një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës;

4.3. tre (3) anëtarë emërohen nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

5. Mandati i anëtarëve të KQZ-së është i lidhur me mandatin e ciklit zgjedhor dhe në parim fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend. Fillimi i mandatit sipas këtij paragrafi, nënkupton përfundimin e mandatit paraprak.

*6. Presidenti i Republikës së Kosovës, bazuar në rezultatet që kanë dalur nga zgjedhjet e përgjithshme, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas certifikimit të zgjedhjeve për Kuvend, u kërkon grupeve parlamentare/subjekteve politike që të propozojnë me shkrim kandidatët për anëtar të KQZ. Grupet parlamentare/subjektet politike brenda afatit prej shtatë (7) ditësh i dërgojnë propozimet e tyre dhe emërimi nga Presidenti bëhet brenda pesë (5) ditësh nga dërgimi i propozimeve.
[...]"*

Pranueshmëria e kërkesës

36. Në mënyrë që të vendosë lidhur me kërkesën e parashtrueses së kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kriteret e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe saktësuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, ku edhe përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur lidhur me rastet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës, përkatësisht Presidentja.

38. Në bazë të nenit 113, paragrafit 2 të Kushtetutës, "[...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është i] autorizuar të ngrejë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të [...] Kryeministrit, dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën;

(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

39. Më tej, neni 113, paragrafi 3 i Kushtetutës përcakton që [...], Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është i] autorizuar të ngrejë çështjet në vijim:

(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;

(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;

(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;

(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.

40. Gjykata po ashtu u referohet paragrafëve (2) dhe (9) të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit], të ndërlidhur me dispozitat e lartcekura, përcaktojnë:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë

[...]

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;

[...]

41. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht vëren se bazuar në faktet e këtij rasti, rezulton se (i) Presidentja kishte dërguar kërkesë te grupet parlamentare/subjektet politike për nominimin e kandidatëve për anëtarë të KQZ-së; dhe (ii) ndërmjet 10 marsit dhe 16 marsit 2026, grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara, përkatësisht LVV, PDK, LDK dhe AAK, kishin propozuar kandidatët për anëtarët përkatës, ndërsa subjektet politike të cilat mbajnë vende të garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë, gjithashtu kishin dorëzuar nominimet e tyre.
42. Presidentja e Republikës së Kosovës ka emëruar nëntë (9) anëtarë të KQZ-së. Një (1) anëtarë tjetër i KQZ-së nuk është emëruar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sepse (i) LVV-ja ka propozuar tre (3) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, ndërsa PDK ka propozuar dy (2) kandidatë për anëtarë të KQZ-së, dhe në kontekst të paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës që përcakton se *“nëse në Kuvend janë të përfaqësuar më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë”*, Presidentja e Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për vlerësimin e *“konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese sipas nenit 113 (3) (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*, përkatësisht konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit dhe Presidentit, në ndërlidhje me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke qenë se nga grupet parlamentare, për dhjetë (10) vende për anëtarë të KQZ-së janë pranuar njëmbëdhjetë (11) propozime, përkatësisht për një (1) vend të mbetur ekzistojnë dy propozime, një (1) nga Grupi më i madh parlamentar LVV, ndërsa një (1) nga Grupi i dytë më i madh parlamentar PDK.
43. Gjykata rithekson se në kërkesën e Presidentes kërkohet që të bëhet *“vlerësimi preventiv i konfliktit të kompetencave në rastin kur Presidentja pranon më shumë propozime për emërim të anëtarëve në KQZ nga grupet parlamentare, sesa që është e përcaktuar me Kushtetutë”*, duke shtuar se *“një vlerësim i tillë nga ana e Gjykatës konsiderojmë se është i domosdoshëm për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe funksionimin demokratik e kushtetues të institucioneve, përkatësisht KQZ-së.”* Sipas Presidentes, *“zgjidhja e këtij konflikti kompetencash detyrëimisht reflekton nevojën që të sqarohet çështja e ndarjes së anëtarit/anëtarëve të mbetur, në rast se janë më pak se gjashtë (6) grupe parlamentare të përfaqësuar në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara.”* Kjo duke qenë se, sipas paragrafit 4 të nenit 139 të Kushtetutës, *“Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuar në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara.”* Ndërsa, *“Nëse në Kuvend janë të përfaqësuar më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë.”*

44. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se Presidentja, në cilësinë e parashtrueses së kërkesës, ka ngritur rast të konfliktit të kompetencës kushtetuese në mes të Presidentit dhe Kuvendit, përkatësisht grupeve parlamentare, si “trupa të Kuvendit”.
45. Gjykata i referohet edhe njëherë nënparagrafit 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, që përcakton se Presidenti i Republikës së Kosovës është një nga tri palët e autorizuar që të ngre çështje të “konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës”.
46. Gjykata, më tutje, u referohet edhe kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 31 (Saktësimi i kërkesës) dhe 32 (Afatet) të Ligjit, si dhe rregullin 66 (Kërkesa në pajtim me nënparagrafin 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit) të Rregullores së punës, si dispozita që e konkretizojnë më tutje dispozitën e lartcekur kushtetuese për “konflikt në mes të kompetencave kushtetuese”:

Neni 31
(Saktësimi i kërkesës)

Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar që cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfarëdo informate të dobishme në lidhje me konfliktin e supozuar në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 32
(Afatet)

Kërkesa e ngritur në bazë të nenit 31 të këtij ligji parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.

Rregulli 66

(Kërkesa në pajtim me nënparagrafin 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 31 dhe 32 të Ligjit)

- (1) “Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nënparagrafin (1) të paragrafit (3) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 31 (Saktësimi i kërkesës) dhe 32 (Afatet) të Ligjit.
- (2) Kur parashtrohet një kërkesë në pajtim me këtë rregull, pala e autorizuar duhet të specifikojë saktë se çfarë konflikti pretendon se ekziston ndërmjet kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit/es të/së Republikës së Kosovës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- (3) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajve nga dita në të cilën është paraqitur konflikti i pretenduar.
- (4) Gjykata njofton autoritetin, konflikti i kompetencave i të cilit pretendohet. Ai autoritet duhet të përgjigjet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e njoftimit, përveç nëse tregohet arsye e mirë për një kohë më të gjatë dhe nëse kërkesa për zgjatjen e afatit përkatës miratohet.”

47. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton interpretimin e saj përmes praktikës gjyqësore të saj se nënparagrafi 1 i paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës ngërthen në vete tri (3) kushte të nivelit kushtetues, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, përkatësisht domosdoshmërinë që:
- (i) konflikti të ngrihet nga njëra nga tri palët e autorizuara;
 - (ii) çështja të ngrihet për një “kompetencë kushtetuese” të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara; dhe,
 - (iii) të ketë një “konflikt” (shih rastet e Gjykatës: [KO131/18](#), parashtrues: *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 marsit 2019, paragrafi 92; [KO181/18](#), parashtrues: *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2019, paragrafi 58; dhe [KO88/21](#), parashtrues: *Presidentja e Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 korrikut 2021, paragrafi 65).
48. Për sa i takon kushtit të parë, Gjykata ka theksuar që nënparagrafi 1 i paragrafit 3 i nenit 113 të Kushtetutës e autorizon Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë që të ngrenë rast të konfliktit në mes të kompetencave të tyre kushtetuese. Ky autorizim është i ndërsjellë dhe secili prej këtyre palëve të autorizuara mund të ngrenë çështje të konfliktit të kompetencave për njërën apo palën tjetër, duke mos përjashtuar mundësinë e ngritjes së konfliktit kundrejt dy palëve njëkohësisht. Në rastin konkret, kjo kërkesë kushtetuese plotësohet me faktin që kërkesa është parashtruar nga Presidentja, si njëri nga tri palët e mundshme që janë të autorizuara për të ngritur çështje të konfliktit në mes të kompetencave të Qeverisë dhe Kuvendit.
49. Për sa i takon kushtit të dytë, Gjykata vëren që nënparagrafi 1 i paragrafit 3 i nenit 113 të Kushtetutës përcakton që konflikti mund të ngrihet vetëm për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuara. Ndonëse Kushtetuta e lë të hapur objektin e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese, ajo bën një kufizim të rëndësishëm lidhur me atë se konflikti i supozuar i kompetencës kushtetuese duhet të burojë patjetër nga kompetencat kushtetuese të përcaktuara me Kushtetutë për Presidentin, Kuvendin dhe Qeverinë (shih, rastet e Gjykatës [KO131/18](#), cituar më lart, paragrafi 94; [KO181/18](#), cituar më lart, paragrafi 60; dhe [KO88/21](#), cituar më lart, paragrafi 67).
50. Në vazhdim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse, në rastin konkret, është plotësuar kriteri i dytë kushtetues, pra nëse në rastin konkret konflikti i supozuar ngritët për “kompetencë kushtetuese” ndërmjet Presidentes të Republikës, Kuvendit të Kosovës dhe/ose Qeverisë së Kosovës.
51. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesja në kërkesën e saj kërkon nga Gjykata që të bëjë vlerësimin preventiv të konfliktit të kompetencave në rastin kur Presidentja pranon më shumë propozime për emërim të anëtarëve në KQZ nga grupet parlamentare, sesa që është e përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 139 të Kushtetutës, duke specifikuar se zgjidhja e këtij konflikti të kompetencave reflekton nevojës që të sqarohet çështja e ndarjes së anëtarit/anëtarëve të mbetur, në rast se janë më pak se gjashtë (6) grupe parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 4 të nenit 139 të Kushtetutës.
52. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 4 të nenit 139, të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetë të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë”.

53. Gjykata rikujton po ashtu dispozitat relevante të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 84

[Kompetencat e Presidentit]

[...]

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

Neni 139

[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të gjykatave me juridiksion apeli.

[...].

54. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme), i cili në paragrafin 6 të nenit 61 (Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së) përcakton që: *“Presidenti i Republikës së Kosovës, bazuar në rezultatet që kanë dalur nga zgjedhjet e përgjithshme, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas certifikimit të zgjedhjeve për Kuvend, u kërkon grupeve parlamentare/subjekteve politike që të propozojnë me shkrim kandidatët për anëtar të KQZ-së. Grupet parlamentare/subjektet politike brenda afatit prej shtatë (7) ditësh i dërgojnë propozimet e tyre dhe emërimi nga Presidenti bëhet brenda pesë (5) ditësh nga dërgimi i propozimeve”.*
55. Gjykata vëren se neni 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] të Kushtetutës, përcaktojnë kompetencën kushtetuese të Presidentes për emërimin e Kryesuesit të KQZ-së dhe mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij të fundit, por kompetenca e Presidentes për emërimin e anëtarëve të KQZ-së nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, por vetëm me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht me paragrafin 6 të nenit 61 të tij.
56. Duke marrë parasysh që konflikti i kompetencave, në rrethanat e rastit konkret, është ngritur përkitazi me një kompetencë të Presidentes dhe e cila nuk është përcaktuar me Kushtetutë, por me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Gjykata, bazuar në pikën 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës dhe praktikës së saj gjyqësore thekson se konflikti i kompetencave nuk është ngritur përkitazi me *“kompetenca kushtetuese”* të Presidentes dhe për pasojë, nuk është plotësuar kriteri i dytë kushtetues në kontekst të ngritjes së *“konfliktit të kompetencave kushtetuese”* për Presidentin, Kuvendin dhe/ose Qeverinë. (shih, rastin KO88/21, cituar më lart, paragrafi 72)

57. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe paragrafin 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, që përcakton se “*Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë*”; dhe paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, që përcakton se Presidenti/ja “*garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë*”. Megjithatë, asnjëra nga këto dispozita nuk përcakton specifikisht kompetencën e Presidentit/es për të emëruar anëtarët e KQZ-së, por këtë kompetencë e përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme.
58. Marrë parasysh që kriteri i dytë kushtetues në kontekst të nënparagrafit 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, që “*çështja të ngritët për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuar*”, nuk është plotësuar në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, konsideron se nuk është e nevojshme të vlerësojë kushtin e tretë të pranueshmërisë së kërkesës, respektivisht, nëse ekziston “*konflikti*” në mes të kompetencave të Presidentit, Qeverisë dhe Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës KO88/21, cituar më lart, paragrafi 72).
59. Megjithatë, edhe me supozimin se do të plotësohej kushti i dytë, i përcaktuar më lart, që “*çështja të ngritët për një kompetencë kushtetuese të caktuar me Kushtetutë për njërën nga tri palët e autorizuar*”, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, nuk është plotësuar as kushti i tretë, që kërkohet që të ketë një “*konflikt*” lidhur me kompetencat në fjalë. Kjo pasi, në rrethanat e rastit konkret, pavarësisht se grupet parlamentare kishin propozuar më shumë anëtarë për KQZ-në, se sa numri që është përcaktuar me Kushtetutë, as grupet parlamentare, e as Kuvendi si pushtet legjislativ dhe si palë e mundshme në “*konflikt*”, nuk e kanë kontestuar kompetencën e Presidentes për të emëruar anëtarët e KQZ-së, kompetencë e cila, nëpërmjet Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, qartësisht i është përcaktuar Presidentit/es. Prandaj, anëtarët e KQZ-së duhet të emërohen, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe gjithmonë sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 4 të nenit 139 të Kushtetutës.
60. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Gjykatës në rrethanat e rastit konkret, Presidentja e Republikës, ndonëse është palë e autorizuar që të ngritë çështje të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të saj dhe Kuvendit, nuk ka ngritur para Gjykatës konflikt të “*kompetencave kushtetuese*”, sipas përcaktimeve të nënparagrafit 1 të paragrafit 3 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe për pasojë, Gjykata shpall kërkesën e Presidentes së Republikës së Kosovës të papranueshme.

Përkritazi me kërkesën për masë të përkohshme

61. Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar po ashtu caktimin e masës së përkohshme “[...] në zbatimin e afateve ligjore të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me fillimin e mandatit të një (1) anëtarit të KQZ-së, i cili nuk është emëruar në këtë raund për shkak të paqartësive kushtetuese. Në veçanti, nevoja për masë të përkohshme për rrjedhjen e afateve bëhet duke pasur parasysh domosdoshmërinë që veprimet të cilat ndërmerren nga Presidentja lidhur me emërimin e anëtarëve të KQZ-së të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.

62. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 27 (Masat e Përkohshme) të Ligjit, që parashikon se *“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”*. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit 1 të rregullit 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, që përcakton se *“Në çfarëdo kohe, përderisa Gjykata të mos ketë vendosur lidhur me një kërkesë, çdo palë mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme lidhur me çështjen që është objekt i procedurës para saj, siç përcaktohet me nenin 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit”*.
63. Në këtë kontekst, marrë parasysh që Gjykata veçse ka vlerësuar se kërkesa është e papranueshme, Gjykata thekson se është i panevojshëm shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për masë të përkohshme dhe rrjedhimisht kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet (shih, rastin e Gjykatës KO88/21, cituar më lart, paragrafët 74-77).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit, rregullin 45 dhe pikën (b) të paragrafit 1 të rregullit 48 të Rregullores së punës, më 30 mars 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Jeton Bytyqi

Nexhmi Rexhepi